VENDIM
Nr. 776, datë 4.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 703, DATË 30.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NR. 316, ZONA KADASTRALE 2281, BASHKIA CËRRIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 703, datë 30.10.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në titull dhe kudo në tekstin e vendimit, fjalët "... të pasurisë me nr. 316 ..." zëvendësohen me "... të pasurisë me nr. 316/1, volum 15, faqe 136 ...".

2. Në lidhjen nr. 1, në kolonën me emërtimin "Numri i pasurisë", rreshti 1, referenca "... 316 ..." zëvendësohet me "... 316/1, volum 15, faqe 136 ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe